

Bashkimi kombëtar apo Bashkimi Evropian?

Dy rrugëtime të shqiptarëve me drejtime të ndryshme!"

Lirie Hajdari

PRISHTINË, 11 QERSHOR ■ Ideja për bashkim kombëtar tashmë është ngulitur në mendjen dhe zemrën e çdo shqiptari, kudo që jeton ai. Zërat për bashkimin e shqiptarëve nuk datojnë nga sot, por gjatë gjithë historisë është folur e shkruar shumë për bashkimin e shqiptarëve nën një shtet të vetëm. Çështja e bashkimit të shqiptarëve së fundmi është duke u proklamuar më së shumti nga dy forca të reja politike në skenën shqiptare. Lëvizja Vetëvendosje në Kosovë dhe Aleanca Kuq e Zi në Shqipëri, janë zërat që më së shpeshti kërkojnë bashkimin e shqiptarëve në një shtet të vetëm. Por, nuk janë të paktë as ata që bashkimin e shqiptarëve e shohin brenda Bashkimit Evropian. Të ndarë për shumë vite, shqiptarët sot ndjehen më të sigurt dhe

më të bashkuar se kurrë. Autos-trada nacionale "Ibrahim Rugova", Durrës-Merdare dhe abetarja unike janë dy segmentet më të rëndësishme që i bashkon shpirtërisht dhe fizikisht shqiptarët, në tërë hapësirën shqiptare, të cilët për më shumë se gjysmëshekulli e patën të ndaluar të flasin, të komunikojnë e të jetojnë të lirë, në vëllazëri me njëri-tjetrin.

Në një ligjëratë të mbajtur ditë më parë në University of New York in Tirana me temën "Bashkimi Kombëtar dhe Bashkimi Evropian", lideri i Lëvizjes Vetëvendosje Albin Kurti ka folur për vullnetin dhe nevojën e shqiptarëve për t'u bashkuar, duke theksuar që bashkimi kombëtar dhe bashkimi evropian as nuk e përjashtojnë, por as nuk e zëvendësojnë njëra-tjetrën, sepse BE-ja është themeluar nga shtetet e veçanta dhe zhvillohet prapashtet.

Albin Kurti e argumentoi bashkimin kombëtar si demokraci, si sovranitet dhe si zhvillim socio-ekonomik, ndërkohë që foli edhe për shkaqet historike të mungesës së bashkimit kombëtar si për një padrejtësi të vazhdueshme. "Ka një tension evident midis përbashkësisë së shqiptarëve si komb dhe sisteme të veçanta shtetërore që i mbajnë ata të ndarë", tha Albin Kurti. Çështja e bashkimit kombëtar vazhdon ta shtrojë në çdo debat, në çdo tubim dhe takim drejtuesi i Aleancës Kuqezi, Kreshnik Spahiu. Ndryshe nga gjithë të tjerët që bashkimin e shqiptarëve e shohin nën kulmin e BE-së, ai mendon se shqiptarët duhet të bashkohen në një shtet të vetëm para se të anëtarësohen në Bashkimin Evropian.

Osmani: Të bashkuar nën kulmin e BE-së

Por, jo të gjithë mendojnë njësoj sikur Aleanca Kuqezi, ndonëse asnjëherë nuk e përjashtojnë dëshirën për bashkim. Vjosa Osmani, deputete e LDK-së, konsideron se integrimi ndërshqiptarë mund të arrihet vetëm brenda Bashkimit Evropian, madje sipas saj këtë duhet ta ketë të qartë secili. Ajo kërkon nga secili që hedh një ide të tillë po ashtu ta ketë të qartë, se kur një shtet synon integrimin në BE duhet të përcaktohet për kufijtë ekzistues dhe jo të ketë pretendime territoriale, apo pre-

tendime bashkimi, gjë që sipas deputetes Osmani deputetëve të Kosovës iu është bërë e qartë edhe në Parlamentin Evropian, dhe kjo vlen jo vetëm për Kosovën, por edhe për Shqipërinë. Kjo, sipas znj. Osmani, nënkupton që edhe Shqipëria do të duhej t'i harronte ëndrrat e BE-së sikur të deklarohet apo të punonte në favor të bashkimit. Duke pasur parasysh që në momentin kur shtetet janë brenda BE-së hiqen barrierat, përfundimisht, promovohet lëvizja e lirë, bashkëpunimi ekonomik, gjuhësor dhe gjitha aspektet tjera, atëherë ajo beson se rruga më e mirë për Kosovën, dhe që përkrahet nga 90 për qind e qytetarëve të Kosovës është rruga e integritimit në BE. "Unë i kuptoj përfaqësuesit e partive të tjera se mund të kenë mendime të ndryshme, por qëndrimi i LDK-së është se ne të gjithë do të jemi të bashkuar, duke përfshirë këtu Shqipërinë, madje edhe me vendet e rajonit, brenda kulmit të BE-së", tha deputetja Osmani. Ajo nuk harroi pa përmendur qëndrimin kryesor të Presidentit Historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, i cili vazhdimisht pohonte se Kosova duhet të jetë e hapur me Shqipërinë, por edhe me Serbinë, qëndrim ky të cilin LDK-ja vazhdon ta ketë edhe sot.

Për deputetin e AAK-së, Ahmet Isufi, i mirë është edhe bashkimi kombëtar, por edhe bashkimi



Evropian. "Të dyja janë të domosdoshme, për shkak se në njërin anë një popull kur është i bashkuar tregon fuqinë e vet, organizimin e vet shtetëror e institucionin, por rrethanat që e kanë sjellë popullin shqiptar të ndarë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Preshevë, Bujanovc e Mal të Zi, është tregues se historia ka qenë e padrejtë me shqiptarët dhe rrjedhat për ndarje të territoreve që janë

Presidentja Jahjaga dekoroi 30 personalitete vendore e ndërkombëtare

Me rastin e 12 Qershorit, Ditës së Lirisë të Republikës së Kosovës, Presidentja Jahjaga mori vendim për të dekoruar një numër personalitetesh të vendit dhe ndërkombëtarë.

Vendimi për dekorim u mor në bazë të nenit 84 pika 28 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 dhe 9 të Ligjit për Dhënie dhe Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të Rregullores mbi Llojet e Dekoratave që i jep Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Procedurat për Dhënie e Tyre, si dhe në bazë të raportit të Komisionit Vlerësues për dhënie dhe dekoratave.

Dekoratat u dhanë për këto personalitete: Xhevat Ahmet Berisha, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

1. Hakif Zejnullahu, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

2. Edmond Hoxha, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

Kosovës;

3. Agron Rama, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

4. Mehë Ramë Uka, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

5. Rrahim Samiu-ZOGU, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

6. Shemsî Ahmeti, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

7. Shefko Salković, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

8. Ismet Asllani, dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës;

9. Mulla Idriz Gjilani, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË,

për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

10. Atë Luigj Palaj, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

11. Atë Shtjefen Gjeçovi, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

12. Shkumbin Terpeza, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

13. Ali Bajraktari, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

14. Shemso Ferri, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

15. Shyhrete Berisha, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

16. Ylfete Humolli, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës;

17. Vjollca Berisha, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË,

për kontributin e lartë për liri të Kosovës.

18. Sale Jashari, dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË "ADEM JASHARI", për trimëri në luftën për liri;

19. Nekibe Kelmendi, dekorohet me dekoratën URDHRI PËR PAQE, DEMOKRACI DHE HUMANIZËM "DR. IBRAHIM RUGOVA", për veprën jetësore si kontribut i veçantë për ndërtimin e paqes, zhvillimin e demokracisë, dhe kultivimin e humanizmit;

20. Viktor Meier, dekorohet me dekoratën URDHRI PËR PAQE, DEMOKRACI DHE HUMANIZËM "DR. IBRAHIM RUGOVA", për veprën jetësore si kontribut i veçantë për ndërtimin e paqes, zhvillimin e demokracisë, dhe kultivimin e humanizmit;

21. Shadete Mekuli, dekorohet me dekoratën MEDALJA HUMANITARE e dhënë në çështjet humanitare;

22. Flora Brovina, dekorohet me dekoratën MEDALJA HUMANITARE "NËNA TEREZE" për kontributin e dhënë në çështjet humanitare;

23. Nurije Zekaj, dekorohet me dekoratën MEDALJA E PAQES DHE PAJTIMIT "ANTON ÇETTA" për kontributin e dhënë për paqen dhe pajtimin midis njerëzve;

24. Drita Begraca, dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE për kontributin e dhënë në fushën e arsimit;

25. Walter Happer, dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit;

26. Safete Rugova, dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE për kontributin e dhënë në fushën e artit;

27. Katarina Josipi, dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE, për kontributin e dhënë në fushën e artit;

28. Melihate Ajeti, dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE për kontributin e dhënë në fushën e artit;

29. Nadira Avdiq Vilasi, dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE për kontributin e dhënë në fushën e arsimit dhe kulturës. ■